

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>fage 1 nga 34</i>

KODI I RRJETIT – KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV

Tetor 2018

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 2 nga 34</i>

Përmbajtja

1	Hyrje.....	5
2	Kodi i Planifikimit të Ndërprerjeve.....	6
2.1	Parathënie	6
2.2	Objektivi.....	6
2.3	Fushëveprimi.....	6
2.4	Objektivi.....	7
2.5	Standardet e mirëmbajtjes së Sistemit të Transmisionit.....	7
2.6	Procedura për ndërprerjet që ndikojnë në Sistemin e Transmisionit.....	8
2.6.1	Përshkrim i përgjithshëm.....	8
2.6.2	Afatet kohore	8
2.6.3	Propozimet fillestare	11
2.6.4	Orari preliminar i ndërprerjeve.....	11
2.6.5	Orari final i ndërprerjeve	12
2.7	Ndërprerjet e Sistemit të Transmisionit dhe përdoruesve	12
2.7.1	Ndërprerjet e planifikuara	13
2.7.2	Ndërprerje të paplanifikuara	13
2.7.3	Ndryshimet e kërkuara nga OST.....	14
2.7.4	Ndryshimet e kërkuara nga përdoruesit.....	14
2.7.5	Situatat emergjente	15
2.7.6	Njoftimet për ndërprerjet e detyruara dhe për shkak të prishjeve të përdoruesve dhe ndërprerjet e OST.....	16
3	Kodi i vlerësimit të sistemit.....	16
3.1	Parathënie	16
3.2	Objektivat	16
3.3	Fushëveprimi.....	17
3.4	Parashikimet e OST.....	17
3.4.1	Parashikimet e kërkesës dhe pengesave	17
3.4.2	Parashikimet e kërkesës	17
3.4.3	Pengesat e Sistemit të Transmisionit	18



KODI I RRJETIT
KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV

PO-KO-005

ver. 2.4

fajqe 3 nga 34

3.4.4	Publikimet e parashikimeve	Error! Bookmark not defined.
3.5	Informatat që duhet dhënë OST-së.....	18
3.5.1	Informatat e përgjithshme.....	18
3.5.2	Informatat mujore	18
3.5.3	Informatat javore	19
3.5.4	Informatat ditore	Error! Bookmark not defined.
3.6	Parashikimet e gjenerimit	19
3.7	Parashikimi i kërkesës për ditën në vazhdim.....	21
3.7.2	Përmbajtja e parashikimit të kërkesës për ditën në vazhdim	21
3.7.3	Freskimi i parashikimit të kërkesës	Error! Bookmark not defined.
3.7.4	Raportimi i Operatorit të Sistemit.....	Error! Bookmark not defined.
3.8	Kërkesat për rezerva.....	21
3.9	Kapaciteti i interkoneksioneve	22
3.10	Ad-Hoc – Freskimi i parashikimit	Error! Bookmark not defined.
3.11	Vlerësimi i sigurisë.....	22
3.11.1	E përgjithshme.....	22
3.11.2	Procesi	23
3.11.3	Grumbullimi i informacionit.....	23
3.11.4	Analiza e informacionit.....	23
3.11.5	Konfidencialiteti.....	23
3.11.6	Publikimi	24
3.12	Vlerësimet e sigurisë të Sistemit Energjetik (PSSA-të)	24
3.12.1	PSSA mujore	24
3.12.2	PSSA-të sezonale	25
3.12.3	PSSA-të javore.....	25
3.12.4	E përgjithshme.....	26
4	Kodi i Programimit	26
4.1	Parathënie	26
4.2	Objektivat	27
4.3	Fushëveprimi.....	27
4.4	Dorëzimet nga palët tregtare	28
4.4.1	Njoftimet fizike (NjF).....	28



KODI I RRJETIT
KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV

PO-KO-005

ver. 2.4

fage 4 nga 34

4.4.2	Të dhënat e parametrave dinamik.....	28
4.4.3	Kontrollimi dhe miratimi i Dorëzimeve	28
4.4.4	Trajtimi i dorëzimeve të pavlefshme	29
4.4.5	Ofertat për shitje -blerje	29
4.4.6	Pezullimi i tregut të energjisë elektrike.....	30
4.4.7	Shërbimet ndihmëse.....	30
4.4.8	Komunikimet	30
4.4.9	Formati i programeve.....	Error! Bookmark not defined.
4.4.10	Ditët jo - pune.....	31
4.4.11	Ndryshimet e programeve të aprovuara në raste emergjente	Error! Bookmark not defined.
5	Shtojca 1 – Të dhënat e parametrave dinamik.....	32
5.1	Të dhënat mbi disponueshmërinë.....	32
5.2	Të dhënat për shkallën (shpejtësinë) e ndryshimit të ngarkesës.....	32
5.3	Kufijtë operativ	32
5.4	Kërkesat për njoftim	33
5.5	Informatat tjera për Njësine Gjeneruese.....	33
5.6	Programimi i ngarkesave dhe parametrat e dispeçimit.....	34

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 5 nga 34</i>

Kodi i Planifikimit Operativ

1 Hyrje

- 1.1 **Kodi i planifikimit operativ** mbulon periudhën prej një viti në vazhdim deri në fazën e balancimit në kohën reale. Përfshin planifikimin e ndërprerjeve, vlerësimin e sistemit dhe programin për ditën në vazhdim.
- 1.2 **Kodi i planifikimit operativ** nuk është një njësi e vetme por përbëhet nga nën-kodet e mëposhtme:
- a) **Kodi i planifikimit të ndërprerjeve**
 - b) **Kodi i vlerësimit të sistemit**
 - c) **Kodi i skedulimit**
- 1.3 Për të përmbushur përgjegjësitë e tij sipas **kodit të planifikimit operativ**, **OST** kërkon informacione prej **shfrytëzuesve** brenda Kosovës. Këta **shfrytëzues** janë të detyruar me ligj të ofrojnë këto informacione, saktë si dhe në formatin dhe afatin kohor të kërkuar. **OST** gjithashtu kërkon informacione edhe nga palët e interkonektuara. Palët e interkonektuara nuk janë të detyruara me kërkesat e këtij kodi por nga marrëveshje të tjera dypalëshe dhe shumëpalëshe.

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 6 nga 34</i>

2 Kodi i Planifikimit të Ndërprerjeve

2.1 Parathënie

Ky kod përcakton procedurat për:

- a) Koordinimin dhe aprovimin e **ndërprerjeve** të planifikuara të **njësive gjeneruese**;
- b) Koordinimin e **ndërprerjeve** të planifikuara në **Sistemin e Transmetimit** dhe të **stabilimenteve dhe aparaturave** të lidhura direkt me **Sistemin e Transmetimit**;
- c) Shkëmbimin e nevojshëm të informacionit ndërmjet **OST** dhe **shfrytëzuesve** për përpilimin e planeve të **ndërprerjeve** për **Sistemin e Transmetimit**;
- d) Shkëmbimin e informacionit me **OST**-të e tjera në lidhje me **ndërprerjet** që kanë ndikim në interkoneksionet ndërshtetërore¹;
- e) Hapat që duhen ndërmarrë nga **OST** për të trajtuar **ndërprerjet** e paplanifikuara.

2.2 Objektivi

2.2.1 Objektivi i këtij kodi është të sigurojë që **ndërprerjet** e të gjitha **njësive gjeneruese, shfrytëzuesve** të kyçur drejtpërdrejtë në **Sistemin e Transmetimit** dhe **ndërprerjet** në **Sistemin e Transmetimit** janë të miratuara dhe të koordinuara. Koordinimi kërkohet për tu siguruar se siguria dhe cilësia e standardeve të furnizimit në **Sistemin e Transmetimit** janë plotësuar dhe aq sa është e mundur të minimizohen pengesat dhe efekti i tyre në **Sistemin e Transmetimit**.

2.2.2 Kodi i planifikimit të ndërprerjeve duhet të përcaktoj procedurat e duhura që lejojnë koordinimin mes OST dhe OST-ve fqinje në lidhje me **ndërprerjet** që kanë ndikim në rrjedhat e fuqisë në interkoneksion.

2.3 Fushëveprimi

Kodi i planifikimit të ndërprerjeve aplikohet tek:

- a) **OST**;

¹ Ky informacion është në dispozicion sipas kushteve të marrëveshjeve të interkoneksionit

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 7 nga 34</i>

- b) **Prodhuesit me njësi gjeneruese të kyçura në Sistemin e Transmetimit dhe prodhuesit me njësi gjeneruese më të mëdha se 5 MW të kyçura në sistemin e shpërndarjes duke përfshirë Modulin e parkut gjenerues (Stacionet gjeneruese të energjisë diellore dhe të erës me kapacitet të instaluar ≥ 5 MW);**
- c) **OSSH-të;**
- d) **Shfrytëzues të tjerë të kyçur direkt në Sistemin e Transmetimit.**

2.4 Objektivi

2.4.1 Qëllimi i këtij kodi është të sigurojë që shfrytëzuesit të ofrojnë informacionet e nevojshme për:

- a) Operimin e sigurt të **Sistemit të Transmetimit**.
- b) Të lejuar **OST** të përfundojë vlerësimet për ndikimin që kanë **ndërprerjet** në rrjedhat e fuqisë në **interkoneksion**.

2.4.2 Niveli i këtij informacioni varet nga përmasa, vendndodhja dhe lloji i instalimit të **shfrytëzuesit** si dhe nëse informacionet e ofruara në secilën periudhë vërtetojnë të dhënat e ofruara më parë.

2.5 Standardet e mirëmbajtjes së Sistemit të Transmetimit

2.5.1 **OST** duhet të mirëmbajë **Sistemin e Transmetimit** sipas standardeve aktuale për mirëmbajtjen, inspektimin, riparimin dhe zëvendësimin e pajisjeve të **sistemit të transmetimit**. Këto standarde do të sigurojnë shërbim të sigurt, të besueshëm dhe me cilësi të lartë dhe do të marrin në konsiderim koston, vendndodhjen dhe motin, standardet e aplikueshme për siguri dhe cilësi të furnizimit, praktikat kombëtare të industrisë elektrike dhe përvojën inxhinierike.

2.5.2 Sistemi i mirëmbajtjes dhe riparimit duhet të sigurojë që punimet të kryhen në periudha të caktuara dhe sipas një procedure të përcaktuar. Këto dy sisteme kanë për qëllim t'i mbajnë pajisjet e **Sistemit të Transmetimit** në operim efikas dhe përdorimin e fuqisë punëtore dhe materiale në mënyrë optimale.

2.5.3 Puna që duhet të kryhet do të përfshijë:

- a) Mirëmbajtjen e pajisjeve;
- b) Riparimet e planifikuara dhe parandaluese të pajisjeve.

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 8 nga 34</i>

- 2.5.4 Planet për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve të **Sistemit të Transmetimit** duhet të dakordohen mes **OST** dhe **shfrytëzuesve** në përputhje me kërkesat ekzistuese dhe me këtë kod si dhe duke marrë parasysh kushtet specifike lokale.
- 2.5.5 Përgjegjësia për mirëmbajtjen, riparimet, azhurnimin dhe renovimin e pajisjeve të **Sistemit të Transmetimit** do të mbahet nga **OST**.

2.6 Procedura për ndërprerjet që ndikojnë në Sistemin e Transmetimit

2.6.1 Përshkrim i përgjithshëm

OST do të jetë përgjegjës për koordinimin e **ndërprerjeve** të planifikuara në transmetim me ndërprerjet e planifikuara të **njësive gjeneruese** dhe **shfrytëzuesve** të tjerë të lidhur direkt në **Sistemin e Transmetimit**. Është thelbësore që të gjitha programet individuale vjetore të **ndërprerjeve** të jenë të koordinuara në mënyrë që të garantojnë sigurinë dhe stabilitetin e operimit të Sistemit Energjetik në tërësi. Në mënyrë që të arrihet ky qëllim i përgjithshëm, **OST** do të veproj si në vijim:

- a) Të shqyrtojë dhe koordinojë datat e propozuara për **ndërprerjet** e planifikuara për **transmetim, gjenerim, shpërndarje** dhe **shfrytëzues** të tjerë;
- b) Të komunikoj me **palët** e ndërlidhura për të ndihmuar në përpjekjet për minimizimin e kufizimeve të pritura gjatë operimit;
- c) Të rekomandoj përshtatjet për **ndërprerjet** e planifikuara përgjatë vitit në mënyrë që të përmirësojë koordinimin e orareve të planifikuara të **ndërprerjeve**:

2.6.2 Afatet kohore

2.6.2.1 Programi vjetor i **ndërprerjeve** përbëhet nga oraret individuale vjetore të ndërprerjeve për stabilimentet dhe aparaturat e **shfrytëzuesit** përkatës. Po ashtu përfshin **ndërprerjet** në **Sistemin e Transmetimit** dhe **ndërprerjet** në Sistemin e Shpërndarjes. Datat sipas të cilave veprimet e ndryshme duhet të kryhen janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:



KODI I RRJETIT
KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV

PO-KO-005

ver. 2.4

faqe 9 nga 34

Veprimi	Data	Nga Kush
Orari i ndërprerjeve për linjat e transmetimit dhe pajisjet e transmetimit	Korrik	OST
Orari i ndërprerjeve për pajisjet shpërndarëse që ndikon mbi transmetimin	Korrik	OSSh
Aplikimi për njësitë gjeneruese të kyçura në transmetim dhe orari i ndërprerjeve	Shtator	Gjeneratorët
Harmonizimi i planeve të ndërprerjeve në transmetim dhe shpërndarje me planet e ndërprerjeve të gjenerimit – zhvillimi i planit të propozuar për ndërprerjet	Tetor	OST /OSSh/ Gjeneratorët
Negocimi i planit të propozuar për ndërprerjet me Qendrat e Dispečimit të shteteve fqinje	Tetor	OST
Aprovimi i orareve finale	Nëntor	OST
Lëshimi i orarit final të dakorduar	Nëntor	OST
Fillimi i orarit të ndërprerjeve	Janar (V+ 1)	Të gjithë

2.6.2.2 Orari vjetor i planifikuar për **ndërprerjet** do të përgatitet duke përdorur një proces me dy faza që pason me dorëzimin e informacionit në **OST**. Së pari **OST** do të konsiderojë **ndërprerjet** e propozuara në **Sistemin e Transmetimit** dhe **ndërprerjet** e interkonektorëve dhe të pajisjeve të shpërndarjes që mund të ndikojnë mbi **Sistemin e**

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 10 nga 34</i>

Transmetimit. Informacioni për kryerjen e këtij veprimi duhet të jetë i gatshëm deri në Korrik.

2.6.2.3 **OST** në përgatitjen e draftit të parë të orarit të **ndërprerjeve** do të veprojë në mënyrë jo-diskriminuese duke iu dhënë përparësi **shfrytëzuesve** në baza rotative. **OST** do të diskutojë çdo pretendim me palët e përfshira. Faza e dytë do të ndërmerret pasi i gjithë informacioni mbi **ndërprerjet** në **njësitë gjeneruese** është i gatshëm në fillim të Shtatorit. Në rast se ka ndonjë konflikt **OST** do t'i diskutojë ato me **palët** e përfshira. Nëse nuk mund të arrihet asnjë zgjidhje me marrëveshje atëherë **OST** do të marrë vendimin final dhe do të nxjerrë propozimin e planit të **ndërprerjeve** (në fund të Shtatorit), i cili i komunikohet **Rregullatorit** përmes dokumentit Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike.

2.6.2.4 Faza finale në vazhdim është harmonizimi i planit të propozuar për **ndërprerjet** në lidhje me oraret e **ndërprerjeve** për **interkoneksion** me shtetet fqinje. Pasi të dakordohet deri në mes të Tetorit, **OST** do të aplikojë korrektimet e nevojshme dhe do të nxjerrë planin final të **ndërprerjeve** deri në mesin e Nëntorit.

2.6.2.5 Në përgatitjen e këtij orari, **OST** do të përpiqet, me sa është e mundur në mënyrë të arsyeshme, të plotësojë kërkesat e të gjitha **palëve** si dhe kërkesat nga **Plani Zhvillimor i Transmetimit (PZhT)**. Sidoqoftë **OST** ka një përgjegjësi absolute për mirëmbajtjen e sigurisë dhe cilësisë së standardeve të furnizimit dhe orari i **ndërprerjeve** do të bëhet sipas prioriteteve të përcaktuara në orar. Aty ku **OST** përcakton, me gjykimin e tij të arsyeshëm, se **ndërprerjet** e propozuara do të çonin në shkeljen e standardeve të sigurisë dhe/ose cilësisë, **OST** do të bëjë ndryshimet e nevojshme në propozimet për **ndërprerje** për ta korrigjuar situatën. Për të bërë këtë arsyetim, **OST** do të konsiderojë të gjithë faktorët dhe do të veprojë në mënyrë jo-diskriminuese.

2.6.2.6 Pas kriterëve të sigurisë dhe cilësisë, **OST** do të përpiqet të minimizojë kostot e kufizimeve në **transmetim** të shkaktuara në situata të **ndërprerjeve**. Megjithatë **prodhuesit** ose **shfrytëzuesit** e tjerë nuk duhet të jenë të obliguar të dakordohen me ndryshimet në propozimet e tyre për **ndërprerjet**. Sidoqoftë për këtë arsye, atyre do t'u kërkohet të konsiderojnë propozimet e bëra nga **OST**, në interes të menaxhimit të përgjithshëm ekonomik të Sistemit Energjetik të Kosovës.

Në të gjitha fazat e procesit **OST** do të veprojë me maturi.

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>fajqe 11 nga 34</i>

2.6.3 Propozimet fillestare

2.6.3.1 Kur dorëzohen propozimet për **ndërprerje, shfrytëzuesi** duhet ta bazojë kërkesën e tij në informacionet e mëposhtme:

- a) Kërkesat për riparimin dhe mirëmbajtjen e **stabilimentit dhe aparaturave të Sistemit të Transmetimit;**
- b) Kërkesat për riparimin dhe mirëmbajtjen e **stabilimentit dhe aparaturave të shfrytëzuesit** dhe pajisjeve të përdorura për **kyçje** me **Sistemin e Transmetimit;**
- c) Analizën e kushteve ekzistuese teknike të **stabilimentit dhe aparaturave** dhe pajisjeve të lidhura dhe kontrollet e defekteve nga riparimet e mëparshme.

2.6.3.2 Kërkesa do të përmbajë minimum informacionet e mëposhtme:

- a) Emrin e **stabilimentit dhe aparaturave** të transmisionit në fjalë;
- b) Emrin e **njësisë gjeneruese** dhe/ose të pajisjeve të **centralit elektrik** në fjalë;
- c) Emrin e **stabilimentit dhe aparaturave** të shpërndarjes në fjalë;
- d) Emri i **stabilimentit dhe aparaturave** gjegjëse të konsumatorit të fuqisë që është i lidhur direkt;
- e) MW ose kapaciteti në fjalë;
- f) Kohëzgjatja e kërkuar e **ndërprerjes;**
- g) Koha minimale e kthimit në punë (mund të jetë e ndryshme në faza të ndryshme të **ndërprerjes**);
- h) Data e preferuar e fillimit dhe ora e fillimit ose diapazoni i fillimit dhe mbarimit:

2.6.4 Orari preliminar i ndërprerjeve

OST do të përgatisë orarin fillestar vjetor të ndërprerjeve deri në fund të Korrikut duke përfshirë vetëm ndërprerjet në **Sistemin e Transmetimit**. Pas arritjes së marrëveshjes preliminare **OST** do ta rishikoj atë pas përfshirjes së ndërprerjeve të **njësisve gjeneruese** dhe të **interkoneksioneve** për vitin e ardhshëm kalendarik për të dhënë orarin preliminar të **ndërprerjeve**. **OST** do t'u shpërndajë të gjithë **shfrytëzuesve** të **Sistemit të Transmetimit** pjesën përkatëse të orarit preliminar vjetor të **ndërprerjeve** jo më vonë

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>fajqe 12 nga 34</i>

se mesi i Tetorit të vitit vijues kalendarik. Orari preliminar vjetor i ndërprerjeve bazohet në:

- a) Orarin vjetor të **ndërprerjeve të shfrytëzuesve dhe OST**;
- b) Orarin vjetor të **ndërprerjeve për interkonekcionet** sipas marrëveshjeve me OST-të fqinje;
- c) Parashikimin e ngarkesës vjetore sipas **Kodit të Rrjetit**;
- d) Mbajtjen e standardeve të sigurisë dhe cilësisë për **Sistemin Energjetik** të Kosovës;
- e) Minimizimin e pengesave;

2.6.5 Orari final i ndërprerjeve

OST do t'u dorëzojë të gjithë **shfrytëzuesve të Sistemit të Transmetimit dhe Rregullatorit** pjesën përkatëse të orarit vjetor final të **ndërprerjeve** për vitin e ardhshëm kalendarik jo më vonë se mesi i Nëntorit i vitit aktual. Pas kësaj date, datat e **ndërprerjeve** siç janë specifikuar në **planin** final vjetor të **ndërprerjeve** janë të detyrueshme për të gjithë **shfrytëzuesit** dhe mund të ndryshohen vetëm në rrethanat e jashtëzakonshme si:

- a) Në raste të kushteve të rrezikshme operative ose sigurisë dhe stabilitetit të **centralit elektrik**;
- b) Aty ku përndryshe nuk do të kishte kapacitet gjenerues të mjaftueshëm për të përmbushur kërkesën e parashikuar dhe për të mbajtur standardet e sigurisë dhe cilësisë për **Sistemin Energjetik** të Kosovës;
- c) Në raste të pengesave serioze në sistemin rajonal të ndërlidhur të **Sistemit të Transmetimit**;
- d) Në rastin e një marrëveshje të ndërsjellët ndërmjet **OST** dhe **palës** tjetër;
- e) Në rastin e **forcës madhore**:

2.7 Ndërprerjet në Sistemin e Transmetimit dhe sistemin e shfrytëzuesve

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>fajqe 13 nga 34</i>

2.7.1 Ndërprerjet e planifikuara

2.7.1.1 Në mënyrë që të mbahet vazhdimësia dhe zbatueshmëria e orarit vjetor të planifikuar të **ndërprerjeve**, të gjithë **shfrytëzuesit** duhet t'i dorëzojnë **OST** një aplikimin (kërkesën), jo më vonë se data 15 e muajit, në lidhje me çdo **ndërprerje** të planifikuar që do të fillojë në çfarëdo kohe gjatë muajit të ardhshëm.

2.7.1.2 Aplikimi do të përmbajë informacionet e mëposhtme:

- a) Detajet e punëve dhe/ose testeve që do të ndërmerren;
- b) Çdo punë paraprake e nevojshme;
- c) Konfirmimin se të gjitha kontratat (etj) janë në rregull;
- d) Planin e punimeve dhe riskun;
- e) Kohën e restaurimeve emergjente dhe plani përkatës i restaurimit, nëse është i aplikueshëm²;
- f) Konfirmimin se të gjitha procedurat e kontrollit të cilësisë dhe sigurisë janë kryer ose do të kryhen;
- g) Listën dhe kontaktet e personelit përgjegjës.

2.7.1.3 Më pas të gjithë **shfrytëzuesit** do të konfirmojnë kërkesat për **ndërprerje** të paktën shtatë ditë përpara datës së fillimit të **ndërprerjes** të planifikuar.

2.7.2 Ndërprerje të paplanifikuara

2.7.2.1 Në rastin e një **ndërprerje** të paplanifikuar, **OST** do të përdorë renditjen e prioriteteve të mëposhtme:

- a) **Ndërprerjet** e detyruara (emergjente) dhe **ndërprerjet** nga prishjet, që përfshijnë tejkalimet e **ndërprerjeve** të planifikuara aty ku nuk është e mundur të rivendoset stabilimenti në shërbim;
- b) Tejkalimet e **ndërprerjeve** të planifikuara aty ku është e mundur por është ekonomikisht e papranueshme të rivendoset stabilimenti në shërbim;

² Ka raste të ndërprerjeve për mirëmbajtje ku riparimi nuk është i mundur ose merr shumë kohë aq sa është e pa praktikueshme.

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>fajqe 14 nga 34</i>

- c) Në rastet emergjente ose ndonjë situatë të paplanifikuar, tipet e mësipërme të **ndërprerjeve** kanë përparësi ndaj **ndërprerjeve** të planifikuara;
- d) **Ndërprerjet** e pa përfshira në orarin vjetor të planifikuar të **ndërprerjeve** por që përmbushin periudhat e njoftimit në paragrafin 2.7.1;
- e) **Ndërprerjet** e pa përfshira në orarin vjetor të planifikuar të **ndërprerjeve** dhe që nuk përmbushin periudhat e njoftimit në paragrafin 2.7.1 –do të lejohen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.

2.7.2.2 Në rrethana të caktuara, **OST** mund të dakordohet për **ndërprerje** me **shfrytëzues** që mund të shpie në mbingarkesë, si rezultat i ndonjë prishje në sistem. Prandaj për të lejuar **OST** të menaxhojë sistemin do të jetë e nevojshme që **shfrytëzuesi** të dakordojë me veprimet pas prishjes për të siguruar **sistemin**. Në mungesë të dispozitave të tilla **OST** mund të mos lejojë që të ndërmerren **ndërprerjet**.

2.7.2.3 **OST** duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshëm për të lejuar **ndërprerjet** e planifikuara, duke pasur parasysh kostot e konsiderueshme të mundshme për të gjitha **palët** nëse anulohet një **ndërprerje**. Për vendimet e anulimit ose shtyrjes së një **ndërprerje**, dhe aty ku ka alternativa, **OST** me **shfrytëzuesit** e ndikuar dhe ndonjë **palë** tjetër të lidhur do të diskutojë prioritetet dhe do të arrijnë në zgjidhjen më të mirë në këto rrethana. Në të gjitha rastet vendimi final është i **OST**.

2.7.3 Ndryshimet e kërkuara nga OST

Atëherë kur kushtet aktuale ose të parashikuara të sistemit ndryshojnë në mënyrë të tillë që **OST** konsideron se është i këshillueshëm ri caktimi i orareve të **ndërprerjeve** të planifikuara për arsye ekonomike, **OST** duhet të informojë palën tjetër për situatën. Ata mund të vlerësojnë ndikimin e **ndërprerjes** dhe mund ose të veprojnë ose ta shtyjnë **ndërprerjen** për më vonë.

2.7.4 Ndryshimet e kërkuara nga shfrytëzuesit

2.7.4.1 Pas dorëzimit të orarit final vjetor të **ndërprerjeve**, **shfrytëzuesit** mund të kërkojnë ndryshime. Këto ndryshime do të konsiderohen nga **OST** (ku koha e lejon) por nuk do të lejohen nëse shkelen standardet e sigurisë dhe/ose të cilësisë së furnizimit ose shkaktohen kosto shtesë.

2.7.4.2 Në konsiderimin e kërkesave të tilla, **OST** do të përpiqet t'i bëjë të mundur **ndërprerjet** nëpërmjet rikonfigurimit të sistemit ose me rinegocim të **ndërprerjeve** të tjera me palët e

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 15 nga 34</i>

përfshira. Në përputhje me at që u cekë më lart, **OST** do të lejoj ose refuzoj **ndërprerjet** në transmetim duke u bazuar në:

- a) **OST** do të koordinoj dhe do të bëjë çdo përpjekje për aprovimin e të gjitha kërkesave për **ndërprerje** në përputhje me funksionimin e sigurt të qëndrueshëm dhe ekonomik të sistemit, dhe do të koordinoj veprimet e nevojshme për të mbajtur sigurinë dhe cilësinë e standardeve të furnizimit;
- b) **OST** mund të mos e lejoj çdo **ndërprerje** të paplanifikuar ose ndryshim në **ndërprerje** edhe nëse nuk ndikon mbi sigurinë dhe cilësinë e standardeve të furnizimit dhe/ose kostot e pengesave por nëse kohëzgjatja e tij e parashikuar është më e madhe se një ditë pune;
- c) **OST** mund të mos e lejojë çdo **ndërprerje** të paplanifikuar ose ndryshim në **ndërprerje** nëse **OST** përcakton, vetëm me gjykimin e tij, se marrëveshja për **ndërprerje** do të shpie në kosto për shkak të pengesave.

2.7.4.3 Duhet të kuptohet plotësisht se zhvillimi i një orari të integruar ndërprerjesh gjatë një periudhe prej disa muajsh është një proces i përsëritur dhe i ndërlikuar dhe se ndryshimet e mëvonshme do të jenë përgjithësisht të vështira për t'u arritur, sidomos duke pasur parasysh nevojën për të koordinuar ndërprerjet e interkoneksioneve në nivel rajonal sipas Politikës 4 të Doracakut të operimit të **ENTSO-E**. Kjo do të ishte veçanërisht reale në periudhën e pikut të ndërprerjeve. Aty ku është e mundur të gjitha **palët** duhet të shmangin kërkesat për ndryshim të orareve të **ndërprerjeve** pas lëshimit të orarit final vjetor të **ndërprerjeve**.

2.7.5 Situatat emergjente

2.7.5.1 **Sistemi energjetik** është gjithmonë i ekspozuar ndaj prishjeve dhe ndërprerjeve për shkak të **forcës madhore** në pajisjet e transmetimit dhe shpërndarjes dhe njësisive gjeneruese. Në këto raste mund të jetë e nevojshme për **OST** të anuloj apo shtyj për më vonë **ndërprerjet** e planifikuara për një kohë të shkurtër, kur siguria dhe/ose cilësia e standardeve të furnizimit mund të rrezikohet.

2.7.5.2 Në situatat e mëposhtme emergjente, **OST** mund të ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

- a) Të shtyj për më vonë ose të anuloj ndonjë **ndërprerje** në **transmetim**, kur sipas gjykimit të **OST**, operimi i Sistemit Energjetik të Kosovës sipas standardeve të kërkuara të sigurisë dhe/ose cilësisë së furnizimit mund të rrezikohet. **OST** duhet të njoftoj menjëherë të gjitha **palët** e përfshira në **ndërprerje** dhe duhet të

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>fajqe 16 nga 34</i>

bëjë përpjekje të arsyeshme për ri caktimin e orareve të **ndërprerjes** në kohën më të hershme të mundshme që është e përshtatshme për të gjitha **palët**;

- b) Të urdhëroj ndaljen e punës dhe kthimin në shërbim të një pjese ose pjesëve të stabilimentit aty ku **OST** gjykon se vazhdimësia e **ndërprerjes** ose **ndërprerjeve** do të çonte në shkeljen e sigurisë dhe/ose cilësisë së standardeve të furnizimit. Aty ku koha e lejon **OST** do të diskutoj implikimet e çdo vendimi të tillë dhe alternativat e mundshme me **palët** e përfshira:

2.7.5.3 Me kërkesën e palës dhe/ose të **Rregullatorit, OST** do të dorëzoj një raport me shkrim që justifikon arsyet për anulimin apo shtyrjen e një **ndërprerje** të planifikuar.

2.7.6 Njoftimet për ndërprerjet e detyruara dhe për shkak të prishjeve të shfrytëzuesve dhe ndërprerjet e OST

2.7.6.1 Të gjithë **shfrytëzuesit** duhet ta njoftojnë **OST** për ndonjë kërkesë për një **ndërprerje** të detyruar të çdo njësie të pajisjeve të **Sistemit të Transmetimit** ose pajisjeve të kyçura me **Sistemin e Transmetimit**, menjëherë sapo **shfrytëzuesi** të bëhet i vetëdijshëm për nevojën.

2.7.6.2 **OST** me marrjen e një njoftimi për nevojën e një **ndërprerje** të detyruar sipas paragrafit 2.7.6.1 do të informojë menjëherë të gjithë **shfrytëzuesit** që mund të ishin të ndikuar nga **ndërprerja** dhe do të aplikoj të gjitha masat e nevojshme për të minimizuar ndikimin e asaj **ndërprerje** në sigurinë e funksionimit të Sistemit Energjetik të Kosovës, sistemeve energjetike fqinje dhe planit të **ndërprerjeve** të dakorduar.

3 Kodi i vlerësimit të sistemit

3.1 Parathënie

Kodi i vlerësimit të sistemit përcakton procedurat për vlerësimin e sigurisë së sistemit në kohëzgjatjen e funksionimit dhe shkëmbimin e nevojshëm të informacionit për të lejuar **OST** të kryej këtë vlerësim.

3.2 Objektivat

Objektivat e këtij kodi janë si më poshtë:

- a) Të ketë përcaktuar procedura për shkëmbimin e të dhënave të funksionimit duke përfshirë edhe parashikimin e **kërkesës**;

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 17 nga 34</i>

- b) Vlerësimi i sigurisë së **Sistemit Energjetik** të Kosovës në operimin afatmesëm dhe afatgjatë;

3.3 Fushëveprimi

Kod i vlerësimit të sistemit aplikohet për:

- a) **OST**;
- b) **Prodhuesit** duke përfshirë **prodhuesit me njësi gjeneruese** më të mëdha se 5MW të lidhur me **Sistemin e Shpërndarjes** dhe **Modulin e parkut gjenerues (Stacionet gjeneruese të energjisë diellore dhe të erës me kapacitet të instaluar ≥ 5 MW)**;;
- c) **OSSH-të**;
- d) **Shrytëzuesit** e ngarkesës të lidhur direkt me **Sistemin e Transmetimit**;

3.4 Parashikimet e OST

3.4.1 Parashikimet e kërkesës dhe pengesave

Parashikimet e kërkesës dhe pengesave të paraqitura në këtë paragraf i duhen **OST-it** për qëllime operative. **OST-it** i nevojiten parashikimet për të konfirmuar se në shkallën kohore funksionale – deri një vit më vonë – do të ketë prodhim të mjaftueshëm për të plotësuar kërkesën dhe kapacitetin e **Sistemit të Transmetimit** në dispozicion për të mundësuar transportimin duke përmbushur standardet e sigurisë. **Parashikimi i kërkesës** ka të bëjë me kërkesat për fuqi aktive dhe fuqi reaktive.

3.4.2 Parashikimet e kërkesës

OST do të jetë përgjegjës për përgatitjen dhe publikimin e parashikimeve³ të mëposhtme të kërkesës për Sistemin Elektro-Energjetik të Kosovës ose për çdo pjesë të tij të përshtatshme si pjesë e informacionit të vlerësimit të sigurisë. Kërkesa do të jetë kërkesë potenciale e sistemit:

- a) Çdo vit një parashikim të kërkesës maksimale për vitin pasues sipas muajve;
- b) Çdo muaj një parashikim të kërkesës maksimale për muajin pasues sipas ditës;
- c) Çdo javë një parashikim të kërkesës për javën në vijim për secilën ditë;

³ Nevoja për parashikimet e **kërkesës ditore** të **kërkesës** së ditës në vazhdim mbulohen nga kodi i vlerësimit të sistemit (brenda **kodit të planifikimit operativ**).

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 18 nga 34</i>

- d) Çdo ditë një parashikim për çdo orë të ditës në vazhdim.

3.4.3 Pengesat e Sistemit të Transmetimit

OST do të jetë përgjegjës për përgatitjen dhe publikimin në faqen elektronike të OSTT-së të parashikimeve të mëposhtme të vazhdueshme të pengesave në **Sistemin e Transmetimit** – duke përfshirë **interkonekcionet** ndër-shtetërore – ose për çdo pjesë të tij, si pjesë e informacionit të vlerësimit të sigurisë:

- a) Çdo vit një **parashikim i pengesave** në **Sistemin e Transmetimit** për vitin e ardhshëm sipas muajve;
- b) Çdo muaj një **parashikim i pengesave** në **Sistemin e Transmetimit** për muajin e ardhshëm sipas ditës;
- c) Çdo javë një **parashikim i pengesave** në **Sistemin e Transmetimit** për javën në vijim për çdo ditë;
- d) Çdo ditë do të përgatitet parashikimi i kongestionit për ditën e nesërme (DACF⁴). Ky DACF do të përgatitet nga **OST** së bashku me **OST**-të e tjera brenda **ENTSO-E** për të përmbushur kërkesat e marrëveshjeve të DACF të **ENTSO-E**

3.5 Informatat që duhet dhënë OST-së

3.5.1 Informatat e përgjithshme

Informatat që kërkon **OST** sipas paragrafëve të mëposhtëm do të jetë prodhimi neto i çdo **njësie gjeneruese** të kyçur me Sistemin e Shpërndarjes.

3.5.2 Informatat mujore

3.5.2.1 Çdo muaj – deri ditën e 14 – të gjithë **OSSH-të**, **shfrytëzuesit** të lidhur direkt me **Sistemin e Transmetimit** dhe **prodhuesit** sipas centraleve elektrike të tyre përkatëse me **njësi gjeneruese** që kanë një prodhim më të madh se 5 MW, **OST-së** duhet t'i ofrohen informatat e mëposhtme:

⁴ DACF – Day Ahead Congestion Forecast – Parashikimi i kongestionit një ditë para

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 19 nga 34</i>

- a) Parashikimet e **kërkesës** si për **fuqinë aktive** dhe për **fuqinë reaktive** në bazë të **pikës së kyçjes** për secilin nga tre muajt kalendarik në baza ditore;
- b) Profilet e **kërkesës** për **fuqi aktive** dhe reaktive për çdo orë për ditën e parashikuar me **ngarkesën** maksimale të **fuqisë aktive** në **pikën e kyçjes** dhe ditën karakteristike (e specifikuar) të pikut të **ngarkesës** të **Sistemit të Transmetimit**;
- c) Profilet e **kërkesës** për fuqi aktive dhe reaktive për çdo orë për ditën e parashikuar me **ngarkesën** minimale të **fuqisë aktive** në **pikën e kyçjes** dhe ditën karakteristike (e specifikuar) të **ngarkesës** minimale të **Sistemit të Transmetimit**;
- d) Profilet tipike të ngarkesës për çdo orë të ditëve të punës, ditëve të fundjavës dhe ndaras për ditë feste.

3.5.2.2 Data dhe ora e parashikimeve të minimumeve dhe maksimumeve të **kërkesës së fuqisë aktive** në **pikën e kyçjes** do të jepen së bashku me parashikimet e kërkesës. **OST** do t'u siguroj të gjitha **palëve** datat e parashikimeve të maksimumeve dhe minimumeve të kërkesave për **fuqinë aktive** të **Sistemit të Transmetimit** për çdo muaj dhe do ta publikojë këtë informacion në faqen elektronike të tij.

3.5.3 Informatat javore

Çdo javë – deri të Premten të gjitha **OSSH-të**, **shfrytëzuesit** të lidhur direkt me **Sistemin e Transmetimit** dhe **prodhuesit** (sipas **centraleve elektrike** të tyre përkatëse) me njësi që kanë një gjenerim më të madh se 5MW duhet t'i japin **OST-së** informatat e mëposhtme:

- a) Parashikimet e **kërkesës** për **fuqinë aktive** dhe **fuqinë reaktive** në bazë të **pikës së kyçjes** për secilin nga tri javët duke filluar nga e diela – në bazë ore;
- b) Nëse ka ndonjë ndryshim, parashikimet e kërkesës duhet të rifreskohen se paku dy dite para dites D.

3.6 Parashikimet e prodhimit

3.6.1 Parashikimet e përgjithshme

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>fajqe 20 nga 34</i>

Parashikimet e prodhimit i duhen **OST**-së për të kryer vlerësimin e sigurisë së Sistemit Energjetik. Informatat e dhëna në këtë paragraf i shtohen çdo informate që kërkohet sipas kodit të planifikimit të **ndërprerjeve**. Kërkesat janë të detajuara në paragrafët në vazhdim.

3.6.2 Parashikimet mujore

Çdo muaj – deri ditën e 14-të – të gjithë **prodhuesit**, sipas **centraleve elektrike** të tyre përkatëse, me njësi që kanë një prodhim më të madh se 5MW, duhet t'i japin **OST** informatat e mëposhtme për tre muajt e ardhshëm në baza javore:

- a) Disponueshmërinë e synuar të stabilimentit të **prodhuesit** – duke marrë parasysh çdo propozim të **ndërprerjes** të njoftuar sipas **kodit të planifikimit të ndërprerjeve**;
- b) Pengesat në prodhimin e energjisë;
- c) Kushte të tjera të stabilimentit që mund të ndikojnë fizikisht në sigurinë e **sistemit elektro energjetik**.

3.6.3 Parashikimet Javore

Deri të Premten e çdo jave të gjithë **prodhuesit** sipas centraleve elektrike të tyre përkatëse, me njësi që kanë një prodhim më të madh se 5 MW, duhet t'i japin **OST**-ës informatat e mëposhtme për tetë javët në vazhdim në baza ditore:

- a) Disponueshmërinë e synuar– duke marrë parasysh çdo propozim të ndërprerjes të njoftuar sipas **kodit të planifikimit të ndërprerjeve**;
- b) Pengesat në prodhimin e energjisë;
- c) Kushte të tjera të stabilimentit që mund të ndikojnë fizikisht në sigurinë e **sistemit elektro energjetik**.

3.6.4 Parashikimet ditore

Çdo ditë të gjithë **prodhuesit** sipas centraleve elektrike të tyre përkatëse, me njësi që kanë një prodhim më të madh se 5 MW, duhet t'i japin **OST**-ës informatat e mëposhtme për shtatë ditë duke filluar me D + 2:

- a) Disponueshmërinë e synuar të stabilimentit;

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 21 nga 34</i>

- b) Kohët e caktuara për sinkronizimin/desinkronizimin për njësitë gjeneruese me start të ngadalshëm;
- c) Nivelet e parashikuara të vetë-dispečimit;
- d) Kushte të tjera që mund të ndikojnë fizikisht në sigurinë e sistemit energjetik.

3.7 Parashikimi i kërkesës për ditën në vazhdim

Operatori i Sistemit bën parashikimin e kërkesës nacionale. Ky parashikim do të përfshijë një vlerësim të humbjeve në rrjetin e transmetim dhe do të bazohet në faktorët e mëposhtëm:

- a) kërkesa historike;
- b) parashikimi i motit;
- c) periudha e vitit;
- d) dita e javës;
- e) ndonjë ngjarje e jashtëzakonshme.

Parashikimi do të mbulojë vetëm kërkesën në Kosovë dhe nuk do të përfshijë transferimet nga interkonekcionet.

3.7.2 Përmbajtja e parashikimit të kërkesës për ditën në vazhdim

3.7.2.1 **Parashikimi i kërkesës** për ditën në vazhdim do të përmbajë informatat e mëposhtme:

- a) Kërkesa e pritshme për çdo orë (në MW) ;
- b) **Ngarkesa** e pritshme e pafurnizuar (në MW);
- c) Margjina rezervë e kërkuar e **OST** për orë (në MW);

3.7.2.2 Ky **parashikim i kërkesës** së ditës në vazhdim do të publikohet në faqen elektronike deri në orën 10,00 në ditën përpara ditës së dispečimit fizik.

3.8 Kërkesat për rezerva

3.8.1 **Operatori i Sistemit** do të caktojë rezervën në baza ditore bazuar në parashikimet afatgjata për rezervat dhe do t'i përshtatë ato kur është e nevojshme.

3.8.2 **Operatori i Sistemit** do të sigurojë rezervën që konsiderohet e nevojshme për mbajtjen e niveleve të përshtatshme të sigurisë së sistemit me kostot më të ulëta nga kontratat për shërbimet ndihmëse apo **mekanizmi balancues**.

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>fajqe 22 nga 34</i>

3.9 Kapaciteti i interkoneksioneve

3.9.1 Operatori i Sistemit në bashkëpunim me operatorët tjerë në interkoneksion do të përcaktojë kapacitetin e secilit qark të interkoneksionit në bazë vjetore, mujore dhe ditore. Ky informacion do t'i bëhet i ditur **Operatorit të Tregut** në përputhje me Rregullat e Ankandit.

3.9.2 OST definojnë: kapacitetin neto transferues (NTC) dhe Margjinën e besueshmërisë së transmetimit (TRM) ku merren parasysh kushtet e parashikuara në sistemet e transmetimit në rajon.

3.9.3 Kapaciteti transmetues i llogaritur do tu alokohet palëve në përputhje me Rregullat e Ankandit të CAO.

3.10

3.11 Vlerësimi i sigurisë

3.11.1 E përgjithshme

3.11.1.1 **OST** do të ë mundësitë më të përshtatshme të mbajë sigurinë e **sistemit energjetik**, në përputhje me standardet e sigurisë së operimit, ashtu që tregu të funksionojë në mënyrë efektive me minimumin e ndërhyrjeve.

3.11.1.2 **OST** ka përgjegjësinë e vlerësimit, mirëmbajtjes dhe rinovimit të sigurisë së furnizimit dhe vazhdimësisë në afatet kohore të funksionimit. Këto kërkesa përfshijnë afatet kohore si më poshtë:

- a) Afat gjata –për vitin në vazhdim – kjo mbulohet nga PSSA mujore sipas seksionit 3.12.1;
- b) Sezonalë – për sezonet e dimrit dhe të verës sipas **ENTSO-E** – kryesisht për qëllimin e vlerave të koordinuara paraprake të NTC në të gjitha linjat e interkoneksionit sipas seksionit 3.12.2;
- c) Afat mesme – tetë javë në vazhdim – kjo mbulohet me PSSA⁵ javore sipas seksionit 3.12.3;

⁵ PSSA – Power System Security Assessment – Vlerësimi i sigurisë së sistemit energjetik

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>fajqe 23 nga 34</i>

- d) Afat shkurta – për ditën në vazhdim. – kjo mbulohet nga dispozitat e kodit të vlerësimit të sistemit (**Kodi i planifikimit operativ**);

3.11.1.3 Për vlerësimin e sigurisë së sistemit, **OST** duhet të marrë në konsideratë informacionin e dhënë sipas kërkesave të kodit të vlerësimit të sistemit dhe në lidhje me çdo informacion tjetër që është i gatshëm kohë pas kohe.

3.11.2 Procesi

Në vlerësimin e sigurisë të **sistemit energjetik**, **OST** do të ndjekë një proces të tërë që përfshin fazat kyçe në vijim:

- a) Grumbullimin e informacionit;
- b) Analizën e informacionit;
- c) Publikimin e vlerësimeve afatgjata dhe afatmesme të sigurisë së **sistemit energjetik**.

3.11.3 Grumbullimi i informacionit

Informacioni që do të grumbullohet nga **OST** të cilin do ta përdorë në vlerësimin e sigurisë së sistemit është i detajuar në kodin e vlerësimit të sistemit. Të gjitha **palët** që janë të obliguara me kushtet e **Kodit të Rrjetit** do të japin informacionin e detajuar në kodin e vlerësimit të sistemit dhe të gjitha të dhënat e tjera të kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga **OST**. Të dhënat duhet të dërgohen sipas kohës së specifikuar dhe duhet të tregohet shumë kujdes për të siguruar që të dhënat janë të sakta dhe të besueshme.

3.11.4 Analiza e informacionit

3.11.4.1 Procesi i analizës së informacionit do të ndërmerret nga **OST** në mënyrë që të krijohen vlerësimet e sigurisë që do t'i jepen të gjitha palëve sipas paragrafit 3.11.6.

3.11.4.2 Kjo analizë e vlerësimit të sigurisë do të përdorë informacionin e mbledhur sipas paragrafit 3.11.3 më sipër dhe do të përdorë të gjitha mjetet në dispozicion të **OST**. Këto mund të përfshijnë mjete në kohë reale dhe në kohë jo-reale me metodat e përdorura sipas zgjidhjes nga **OST**. **OST** duhet t'i dokumentojë këto metoda dhe duhet t'i vendosë në dispozicion të të gjitha palëve dhe të **Rregullatorit**.

3.11.5 Konfidencialiteti

OST është përgjegjës për konfidencialitetin e të dhënave të mbledhura për qëllimet e vlerësimit të sistemit dhe të planifikimit operativ dhe do të kujdeset për konfidencialitetin

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 24 nga 34</i>

e të dhënave gjatë shkëmbimit të këtyre të dhënave për qëllime operative me **OST** -të e tjera. Këto të dhëna mund të jenë të ndjeshme nga ana komerciale dhe fshehtësia do të respektohet sipas marrëveshjeve bilaterale dhe dispozitave të **Kodit të Rrjetit**.

3.11.6 Publikimi

OST duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të siguruar që t'i japë të gjitha palëve informacione të mjaftueshme. Do të publikojë në faqen elektronike të tij vlerësimet e sigurisë të sistemit energjetik (PSSA) duke dhënë vlerësime të sigurisë së sistemit për të tashmen dhe të ardhmen me detaje të mjaftueshme dhe në intervalet e dakorduara me **Rregullatorin** në mënyrë që të sigurojë se të gjitha palët janë të informuara në mënyrën e duhur për t'iu lejuar atyre të marrin vendime për funksionimin efikas dhe ekonomik të aseteve të tyre. PSSA-të do të mundësojnë si më poshtë:

- a) Do t'ju asistojë **shfrytëzuesve** në planifikimin e punëve të caktuara sipas orarit në stabilimentet dhe aparataturat;
- b) Do t'ju shërbej si informatë të gjitha **palëve** për çështjet potenciale të mundshme të sigurisë së sistemit energjetik.

3.12 Vlerësimet e sigurisë të Sistemit Energjetik (PSSA-të)

3.12.1 PSSA mujore

3.12.1.1 **OST** do të përgatisë dhe publikojë një PSSA mujore çdo muaj deri në ditën e 20 të muajit dhe do të mbulojë periudhën një vjeçare duke filluar me muajin menjëherë pas publikimit. Informacioni që përmban PSSA mujore do të pasqyron vlerësimin në baza javore.

3.12.1.2 PSSA mujore duhet të mbulojë vitin në vazhdim dhe duhet të përmbajë informacionet e mëposhtme:

- a) **Parashikimet e kërkesës** – këto do të mbulojnë vitin në vazhdim në baza javore dhe ditët e parashikuara me ngarkesë maksimale dhe minimale për çdo orë;
- b) Për çdo muaj kalendarik **kërkesa** mesatare për çdo orë për mesataren e **ditëve të punës** në atë muaj dhe të dhënat ekuivalente sa i përket ditëve mesatare që nuk janë **ditë pune** në secilin muaj;
- c) Kërkesat e parashikuara të rezervës në mënyrë që të përmbushin standardet e sigurisë për **sistemin energjetik** të Kosovës;

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>fajqe 25 nga 34</i>

- d) **Gjenerimi** në dispozicion – kapaciteti total i pritur i **gjenerimit** në dispozicion duke përjashtuar ndonjë **njësi gjeneruese** apo **central elektrik** që kanë pengesa energjetike ose pengesa për arsye të tjera në baza javore;
- e) Kërkesa maksimale e pritshme dhe kërkesa mesatare për çdo orë (secila në MW) për çdo muaj të vitit kalendarik në vazhdim.
- f) Vlerësimet e humbjeve në transmision në GWh në baza javore;
- g) Vlerësimet e pengesave në **sistem** në GWh në baza javore;
- h) Detajet e ndonjë situatë të projektuar ku standardet e sigurisë për **Sistemin Energjetik** të Kosovës mund të shkelen:

3.12.1.3 **OST** do t'i vendosë PSSA-të mujore në dispozicion të të gjitha **palëve** dhe **Rregullatorit** në versione elektronike .

3.12.2 PSSA-të sezonale

3.12.2.1 **OST** do të punojë dhe publikojë PSSA sezonale dy herë në vit në Mars dhe Shtator. Do të mbulojë vitin në vazhdim për sezonet e dimrit dhe verës kryesisht për kapacitetet e interkonekcionit. PSSA sezonale do të përmbajë informacionet e mëposhtme:

- a) Parashikimet e **kërkesës** – një parashikim i **kërkesës** maksimale dhe minimale në dimër dhe verë;
- b) Vlerësimet e kapacitetit transferues maksimal dhe minimal të **interkonekcionit** sipas sezonit;
- c) Detajet e ndonjë situatë të planifikuar ku standardet e sigurisë për **Sistemin Energjetik** të Kosovës mund të shkelen:

3.12.2.2 **OST** do t'i vendosë PSSA-të sezonale në dispozicion të të gjitha **palëve** dhe Rregullatorit në versione elektronike.

3.12.3 PSSA-të javore

3.12.3.1 **OST** do të punojë dhe publikojë PSSA javore çdo javë deri të Premten. Do të mbulojë periudhën tetë javore në vazhdim duke filluar të Dielën në vijim. PSSA javore do të punohet në baza ditore.

3.12.3.2 PSSA-ja javore do të përmbajë informacionet e mëposhtme:

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>fajqe 26 nga 34</i>

- a) **Parashikimet e kërkesës** – këto do të mbulojnë tetë javët në vazhdim me bazë ditore dhe ditët e parashikuara me **ngarkesë** maksimale dhe minimale me bazë për çdo orë;
- b) Kërkesat e parashikuara të rezervës në mënyrë që të përmbushin standardet e sigurisë për **sistemin energjetik** të Kosovës;
- c) **Prodhimin** në dispozicion – kapacitetin total të **prodhimit** në dispozicion duke bërë përjashtime për ndonjë **njësi gjeneruese** apo **central elektrik** që kanë pengesa energjetike ose pengesa për arsye të tjera në baza ditore;
- d) Vlerësimet e humbjeve në transmetim në GWh në baza ditore;
- e) Vlerësimet e pengesave në **sistem** në GWh në baza ditore;
- f) Detajet e ndonjë situatë të planifikuar ku standardet e sigurisë për **Sistemin Energjetik** të Kosovës mund të shkelen:

3.12.3.3 **OST** do t'i vendosë PSSA-të javore në dispozicion të të gjitha **palëve** dhe **Rregullatorit** në formën elektronike.

3.12.4 E përgjithshme

3.12.4.1 **OST** mund të përgatisë dhe publikojë versione shtesë të azhurnuara të PSSA-ve mujore, sezonale ose javore në rastet e ndryshimeve të rëndësishme apo arsyeve të tjera që **OST** i konsideron të nevojshme.

3.12.4.2 **OST** duhet të dokumentojë procedurën e përdorur për përgatitjen e PSSA-ve mujore, sezonale dhe javore dhe ta vendosë këtë informacion në dispozicion të çdo **pale** dhe **Rregullatorit** nëse kërkohet.

4 Kodi i Skedulimit

4.1 Parathënie

4.1.1 **Kodi i skedulimit** përcakton procedurën për skedulim ne terma kohor nje dite para. . Gjate këtij procesi **OST** përpilon programin ditor te skedulimit, duke marr parasysh kufizimet operative dhe ato të sistemit.

4.1.2 **Kodi i skedulimit** përcakton procedurat që duhen aplikuar nga **OST**, në rolin e tij si **Operator i Sistemit** dhe pjesëmarrësve të tregut gjatë caktimit te orarit te skedulimit

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>fajqe 27 nga 34</i>

operativ. Detajon procesin sipas të cilit **OST** përgatit një draft orar nga nominimet ditore të dorëzuara nga **pjesëmarrësit e tregut** për të mundësuar vlerësimin e sigurisë së. Ky proces do të marrë në konsiderim kongestionin e sistemit dhe çdo faktor tjetër operativ.

4.1.3 Procedurat e skedulimit janë të lidhura ngushtë me organizimin dhe funksionimin e tregut të energjisë elektrike. Në përgjithësi nominimet ditore kontraktuale për shitblerjen e energjisë elektrike sipas transaksioneve bilaterale dhe kërkesave të tyre për energji. Bazuar në nominimet fillestare të dorëzuara nga pjesëmarrësit në treg, **OST** duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për të ruajtur balancimin e sistemit dhe për të arritur, me sa është e mundur, transmetimin e besueshëm të rrjedhave të energjisë sipas programeve të skeduluara .

4.1.4 Funksionimi i detajuar i tregut të energjisë elektrike dhe marrëveshjet për operimin e tij janë përmbledhur në rregullat e tregut.

4.2 Objektivat

Objektivat e përgjithshme të këtij kodi janë të dyfishta. Së pari për të siguruar se në çdo kohë në zonën rregulluese të Republikës së Kosovës prodhimi dhe importi i energjisë elektrike duhet të jenë të barabartë me ngarkesën dhe eksportin e energjisë elektrike dhe së dyti për të mbajtur margjinën adekuate të rezervës për të siguruar aq sa është e mundur, integritetin e sistemit energjetik si dhe sigurinë dhe cilësinë e furnizimit të Sistemit Energjetik të Kosovës në përputhje me **Kodin e Rrjetit** duke:

- a) Kontrolluar nominimet ditore të **pjesëmarrësve të tregut**;
- b) Marr parasysh kufizimet në rrjet dhe në **sistem**;
- c) Përcaktuar me OST fqinje **kapacitetin neto të transferimit (NTC)** të secilin interkonektor
- d) Miratuar programin e skedulimit në bazë të informacioneve të mësipërme;

4.3 Fushëveprimi

Ky seksion është i detyrueshem për:

- a) **OSTT** në rolin e tij si **Operator i Sistemit** dhe **Operator i Tregut**;
- b) **OSSH-të**;

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>fajqe 28 nga 34</i>

- c) **Prodhuesit me njësi gjeneruese të kyçura në Sistemin e Transmetimit dhe prodhuesit me njësi gjeneruese më të mëdha se 5 MW të kyçura në sistemin e shpërndarjes duke përfshirë Modulin e parkut gjenerues (Stacionet gjeneruese të energjisë diellore dhe të erës me kapacitet të instaluar ≥ 5 MW);**
- d) Të gjitha palët tregtare.

4.4 Nominimet nga palët tregtare

Në mënyrë që të mirembahet siguria dhe stabiliteti i Sistemit Energjetik të Kosovës, **Operatori i Sistemit** duhet të ketë informacion mbi prodhimin e planifikuar dhe atë në disponim dhe konsumin e planifikuar në mënyrë që të menaxhohen mungesat dhe tepricat. Operatorit të Sistemit do t'i nevojitet informacioni për qëllim të balancimit të sistemit dhe për t'u përballur me problemet me tensionet dhe kufizimet në sistem.

4.4.1 Nominimet fizike (NF)

4.4.1.1 Secila **palë tregtare**, duhet të beje nominimet e tyre në pajtueshmëri me afatet kohore të përcaktuara në Rregullat e Tregut për ditën e dispecimit fizik.

4.4.1.2 Nominimet fizike ditore do të përmbajnë përveç kapacitetit fizik edhe parametrat dinamik të dispecimit. Përmbajtja dhe formati i informacionit duhet të dorëzohet siç është përcaktuar në **rregullat e tregut**.

4.4.1.3

4.4.1.4

4.4.2 Parametrat dinamik të dispecimit

Pala tregtare duhet të ofroj të dhënat e **parametrat dinamik të dispecimit** siç detajohet në Shtojcën 1 të **Kodit të planifikimit operativ**. Nëse të dhënat e parametrave **dinamik** të dispecimit nuk kanë ndryshuar nga njoftimi i mëparshëm atëherë ky fakt duhet të shënohet dhe nuk do të kërkohet njoftim i ri për to.

4.4.3 Kontrollimi dhe miratimi i Nominimeve

4.4.3.1 Pas dorëzimit të nominimeve, **OST** duhet të kontrollojë vlefshmërinë e nominimeve të **Nominimeve fizike** dhe parametrave dinamik të dispecimit që janë pranuar nga **Operatori i Tregut** për secilën **palë tregtare**.

4.4.3.2 Një nominim do të deklarohet i pavlefshëm nga **OST** si në rastet e mëposhtme:

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>fajqe 29 nga 34</i>

- a) Kur nuk është dorëzuar asnjë nominim ne afatin e parapere kohor te dorzimit te nominimeve;
- b) **Nominimi** nuk përputhet me formatin dhe përmbajtjen siç është përcaktuar në **rregullat e tregut**;
- c) **OST** ka pranuar një nominim i cili nuk përputhet me nominimin e palës tjetër kontraktuale ;
- d) **Nominimi** përmban vlera nga një **njësi gjeneruese** që tejkalon kapacitetin e regjistruar të asaj **njësie gjeneruese**;

4.4.3.3 **Operatori i Sistemit** duhet të aprovojë secilin nominim që nuk është deklaruar i pavlefshëm. Ky bëhet nominim i miratuar **per** palën tregtare koresponduese. Ky nominim i miratuar do të zbatohet për **ditën** përkatëse të **dispeçimit fizik** dhe do të jetë i detyrueshëm për **palën tregtare**. **OST** do t'ia dërgojë njoftimin per nominimin e miratuar secilës **palë tregtare** ne afatin kohor te përcaktuar ne rregullat e Tregut.

4.4.4 Trajtimi i nominimeve të pavlefshme

4.4.4.1 Nëse **Operatori i Sistemit** deklaron një nominim si të pavlefshëm, atëherë **Operatori i Sistemit** do të informojë **palën tregtare** perkatese se nominimi është deklaruar i pavlefshëm dhe arsyet për pavlefshmërinë e nominimit te tij. **Pala tregtare** më pas do të dorëzojë një nominim të korrektuar sipas afatit kohor te përcaktuar ne Rregullat e Tregut .

4.4.4.2 Pas pranimit te nominimit te korrektuar, **OST** do të kontrollojë vlefshmërinë e nominimit të korrektuar në përputhje me kërkesat e seksionit 4.4.3.

4.4.4.3 **OST** duhet të merret vesh paraprakisht me secilën **palë tregtare** se çfarë veprimi duhet të merret në rastin kur nuk pranohet asnjë nominim i vlefshëm. Nëse nuk ka marrëveshje paraprake, atëherë **OST** do të përdorë nominimin me vlerë më të vogël.

4.4.5 Ofertat për shitje dhe ofertat perblerje

4.4.5.1 Një **palë tregtare** mund të paraqesë **oferta për shitje dhe oferta per blerje** për njësitë balancuese të saj sipas **rregullave të tregut**. **Ofertat për shitje dhe ofertat per blerje** mund të bëhen një ditë para, sipas afatit kohor te përcaktuar ne Rregullat e Tregut.

4.4.5.2 **Operatori i Sistemit** do të aktivizoj **oferta për shitje dhe ofertat per blerje** me qëllim të balancimit të sistemit. **Operatori i Sistemit** po ashtu do të aktivizoj **oferta për shitje dhe oferta per blerje** për të tejkaluar kufizimet në sistem apo për rezerva shtesë. Çdo ofertë e

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>fajqe 30 nga 34</i>

pranuar për shitje dhe oferte për blerje duhet të jetë në përputhje me **të dhënat e parametrave dinamik te dispecimit** (PDD-të) dhe në veçanti me shkallen e shpejtësisë së rritjes dhe zbritjes së podhimit. Në fund të kohës së aktivizimit të ofertave të pranuar për shitje dhe ofertave për blerje, **njësia balancuese** duhet të kthehet në pozicionin e saj të deklaruar të **Nominimeve fizike**.

4.4.6 Pezullimi i tregut të energjisë elektrike

4.4.6.1 Në kushtet e **forcës madhore**, siç mund të jetë një çrregullim i madh i sistemit energjetik, **Operatori i Sistemit** mund të pezullojë tregun e energjisë elektrike. Nën këto kushte **Operatori i Sistemit** do të informojë **Operatorin e Tregut, Rregullatorin**, të gjitha **palët tregtare** dhe të gjitha **OST-të e palëve të interkonektuara** sipas rrethanave.

4.4.6.2 Sipas kushteve në paragrafin 4.4.6.1, Operatori i Sistemit mund të refuzojë të pranojë ose ofrojë ndonjë parashikim apo Nominim.

4.4.6.3 Sa më shpejtë të jetë e mundur **Operatori i Sistemit** do të informojë **Operatorin e Tregut, Rregullatorin**, të gjitha **palët tregtare** dhe **OST -të e palëve të interkonektuara** se tregu i energjisë elektrike do të kthehet apo është kthyer në gjendjen e mëparshme dhe kohën kur kjo ka ndodhur ose do të ndodhë.

4.4.7 Shërbimet ndihmëse

Për secilën njësi balancuese që është e gatshme si **ofruese e shërbimeve ndihmëse**, pala tregtare duhet të dorëzojë një njoftim disponueshmërie jo më vonë se ora 13:00 në D-1 duke treguar gatishmërinë për **ditën e dispecimit fizik**. Njoftimi i disponueshmërisë së paku duhet të përmbajë informacionet e mëposhtme:

- a) Gatishmërinë për secilën **njësi balancuese** për ditën në fjalë;
- b) Programin e **ndërprerjeve** për **ndërprerjet** fleksibil/jofleksibile, njoftimin paraprak për **ndërprerjet** fleksibile, mirëmbajtjen e planifikuar afatshkurtër, kohët e rikthimit në shërbim etj;
- c) Vlerat në MW të rishikuara për periudha të ndryshme të ditës së programuar ku këto ndryshojnë gjatë asaj dite.

4.4.8 Komunikimet

Të gjitha komunikimet ndërmjet **Operatorit të Sistemit** dhe **Operatorit të Tregut** dhe ndërmjet **Operatorit të Sistemit** dhe **palëve tregtare** do të kryhen në mënyrë elektronike..

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 31 nga 34</i>

4.4.9 Ditët jo - pune

Të gjitha aktivitetet e përditshme në lidhje me **Kodin e planifikimit operativ**, parashikimet, nominimet etj. do të ofrohen edhe për të gjitha duke përfshirë edhe ditët e jo – punës. Palët tregtare mund të dorëzojnë nominimet e tyre për një jo Ditë Pune në Ditën e Punës para jo Ditës së Punës..

4.4.11.1

5

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>fajqe 32 nga 34</i>

Shtojca 1 – Të dhënat e parametrave dinamik

Të dhënat e parametrave dinamik (PDD-të) për secilën **njësi gjeneruese** me kapacitet të instaluar prej të paktën 10 MW, duhet të përmbajnë së paku informacionet e cekura në paragrafët në vazhdim:

5.1 Të dhënat mbi disponueshmërinë

Të dhënat mbi disponueshmërinë, shprehur me kohën e disponueshmërisë/jo-disponueshmërisë [(si dita/muaji/viti orë minuta (hhmm))] ose përndryshe si kohëzgjatje (e shprehur në orë: minuta) si më poshtë:

- a) **Ndalja** e planifikuar;
- b) Njoftim i shkurtër për **ndaljen**;
- c) Koha minimale e procesit të ndaljes nga operimi;
- d) Koha minimale e kthimit në operim.

5.2 Të dhënat për shkallën (shpejtësinë) e ndryshimit të ngarkesës

Të dhënat për shkallën e ndryshimit të ngarkesës të shprehur në formën e ndryshimeve MW/minutë në gjenerim duke përfshirë:

- a) Shkallën e rritjes kur nuk ka kufizime;
- b) Shkallën e rritjes mbi GMS⁶ kur ka kufizime;
- c) Shkallën e rritjes nën GMS;
- d) Shkallën e zbritjes kur nuk ka kufizime;
- e) Shkallën e zbritjes mbi GMS kur nuk ka kufizime;
- f) Shkallën e zbritjes nën GMS;

5.3 Kufijtë operativ

Kufijtë operativ të shprehur në MW (ose në MWh dhe hhmm në rastin e kufizimeve në furnizim në hidro central).

- a) KEM⁷ (Kufiri i eksportit maksimal për centralin);

⁶ GMS – Gjenerimi maksimal stabil (Minimum Stable Generation)

⁷ KEM – Kufiri i Eksportit Maksimal (Maximum Export Limit)

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 33 nga 34</i>

- b) KIM⁸ (Kufiri i importit maksimal për njësinë e anës së ngarkesës);
- c) Vëllimi maksimal i furnizuar;
- d) Perioda maksimale e furnizimit;
- e) MQG (Minimumi i gjenerimit stabil);
- f) MQG kur nuk ka kufizime;

5.4 Kërkesat për njoftim

Kërkesat për njoftim shprehen në orë dhe minuta, që nevojiten nga **gjeneruesit** për t'iu përgjigjur një udhëzimi nga **Operatori i Sistemit** që përfshinë:

- a) Njoftimin për devijimin nga zero;
- b) Njoftimin për dorëzimin e **ofertave për shitje**;
- c) Njoftimin për dorëzimin e **ofertave për blerje**;

5.5 Informatat tjera për Njësinë Gjeneruese

Përfshijnë të dhënat e mëposhtme:

- a) Shkallën e rritjes apo zbritjes në rregullatorin e shpejtësisë (%);
- b) Në rastin e turbinave me avull, kohën e sinkronizimit për nivelet e ndryshme të parametrave të avullit dhe përveç kësaj kohën nga sinkronizimi deri në dispeçimin e ngarkesës;
- c) Në rastin e turbinave hidro dhe turbinave me gaz, kohën nga inicimi i startimit deri në arritjen e dispeçimit të ngarkesës;
- d) Kufizimet e numrit të startimeve për ditë të caktuara;
- e) Ngarkesa e blloqeve në MW pas sinkronizimit;
- f) Shkallët maksimale të ngarkesës për nivelet e ndryshme të parametrave të avullit;
- g) Shkallët maksimale të shkarkimit;
- h) Kufijtë e kapacitetit MW dhe MVAr brenda të cilave **njësia gjeneruese** është në gjendje të operoj siç tregohet në grafikun e kapacitetit të **njësisë gjeneruese** përkatëse;

⁸ MIL – Kufiri i Importit Maksimal (Maximum Import Limit)

	KODI I RRJETIT KODI I PLANIFIKIMIT OPERATIV	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>fajqe 34 nga 34</i>

- i) Numri maksimal i cikleve të tejpgarkesës për periudhën 24 orëshe, së bashku me ngarkesat maksimale duke përfshirë rritjet e ngarkesës.

5.6 Programimi i ngarkesave dhe parametrat e dispeçimit

Parametrat e ngarkesës për të gjitha shërbimet e dispeçimit të ngarkesës, minimum do të ofrojnë:

- a) Lokacionin;
- b) Sasinë;
- c) Akordimin e pajisjeve automatike;
- d) Kohën e implementimit.

(Fund i dokumentit)